



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



**Agjencia e Kosovës për Akreditim**  
Agencija Kosova za Akreditaciju  
Kosovo Accreditation Agency

Data: 06.07.2017

Ref.: 534/17

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.20/2016, datë 20.09.2016), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 51-të, të mbajtur më 23 Qershor 2017, mori:

**V E N D I M**

- I. Riakreditohet programi i studimit i Universitetit të Pejës “Haxhi Zeka” për periudhën tre vjeçare, 1 tetor 2017 – 30 shtator 2020:
  - Menaxhim i Burimeve Njerëzore, MSc, 120 ECTS, maksimumi 50 studentë për vit akademik.
- II. Nuk riakreditohen programet e studimit të Universitetit të Pejës “Haxhi Zeka”:
  - Kushtetues Administrativ, LLM, 60 ECTS;
  - Menaxhimi i Mjedisit, MSc, 120 ECTS.
- III. Obligohet Universiteti i Pejës “Haxhi Zeka” që deri me 1 tetor 2017 në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) ta dorëzoj planin e rekrutimit të stafit akademik, për vitin akademik 2017/2018, për arsyeje të pensionimit të mundshëm të stafit, apo për çfarëdo arsyeje tjetër.
- IV. Obligohet Universiteti i Pejës “Haxhi Zeka” që deri me datë 1 dhjetor 2017 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.
- V. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

## Arsyetimi

Universiteti i Pejës “Haxhi Zeka” ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA), për riakreditim të programeve të studimit: Menaxhim i Burimeve Njerëzore, MSc, 120 ECTS, Kushtetues Administrativ, LLM, 60 ECTS, dhe Menaxhimi i Mjedisit, MSc, 120 ECTS, me stafin akademik si në vijim:

Nr.	Programi i studimit	Niveli	ECTS	Bartësit e Programit
1	Menaxhim i Burimeve Njerëzore	MSc	120	Theranda Beqiri, Bedri Statovci, dhe Vehbi Miftari
2	Kushtetues Administrativ	LLM	60	Avdullah Robaj, Sabiha Shala, dhe Veton Vula
3	Menaxhimi i Mjedisit	MSc	120	Adem Dreshaj, Bedri Millaku, dhe Mimoza Hyseni Spahiu

AKA ka organizuar vizitën në Universitetin e Pejës “Haxhi Zeka” më 18.05.2017, me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit të cekura me sipër me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Mladen Krajacic, Tanja Dmitrovic dhe Salvador Rus Ruffino.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur më 23 qershor 2017 ka shqyrtuar aplikacionin e Universitetit të Pejës “Haxhi Zeka”, dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve të akreditimit gjatë realizimit të vizitës, dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportin final nga ekspertët e cekur më sipër, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Në lidhje me programin e studimit Kushtetues Administrativ, LLM, 60 ECTS, raporti i ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit, numëron këto vërejtje kryesore të cilat kanë qar në mos dhënien e rekomandimit për ri/akreditim:

Ekspertët kanë deklaruar se shpërndarja e ngarkesës së mësimdhënies për këtë program të studimit nuk është adekuate sepse një pjese të stafit akademik i cili është caktuar për ligjërimitin e lëndëve mbulon shumë lëndë dhe ECTS, dhe për më tepër njëri nga ta është me angazhim të pjesshëm në Universitetin e Pejës. Sipas ekspertëve nuk është e drejtë që vetëm një pjesë e stafit akademik të kenë ngarkesë aq të madhe dhe ndoshta kjo është arsyeja se pse në dy vitet e fundit vetëm 9 studentë kanë arritur të përfundojnë studimet e tyre me temën e diplomës.

Ekspertët kanë theksuar se numri i stafit akademik është shumë i vogël për 45 studentë të cilët aktualisht janë të regjistruar për shkak të temave të diplomës. Sipas ekspertëve kjo situatë nuk është mirë dhe se universiteti duhet urgjentisht të rekrutojë më tepër mësimdhënës për programin e nivelit Master.

Për sa i përket hulumtimit, ekspertët kanë deklaruar se ky program nuk orientohet kah puna kërkimore. Ekspertët kanë mësuar se në mesin e ligjëruesve vetëm njëri nga ta është bashkë autor i tri publikimeve

dhe një tjetër ka dy kontribute shkencore. Kjo sipas ekspertëve është shumë nivel i ulët i hulumtimit për një program të nivelit Master i cili ka për qëllim që të përgatisë juristë me mentalitet praktik dhe kritik.

Në anën tjetër, ekspertët kanë deklaruar se biblioteka për programin juridik përmban vetëm disa tekste dhe shumica e tyre janë manuale apo libra të shkruar nga profesorët e fakultetit, dhe me orientim për lëndët e nivelit Bachelor. Prandaj sipas ekspertëve është e vështirë që studentët të bëjnë punë të vërtetë hulumtuese në momentin e hartimit të temës së diplomës me kushtet aktuale të bibliotekës.

Në lidhje me programin e studimit Menaxhimi i Mjedisit, MSc, 120 ECTS, raporti i ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit, numëron këto vërejtje kryesore të cilat kanë qar në mos dhënien e rekomandimit për ri/akreditim:

Ekspertët kanë deklaruar se personi kryesor përgjegjës për programin e studimit nuk ka qenë prezent gjatë vizitës së akreditimit dhe rrjedhimisht ekspertëve nuk i janë ofruar informacionet shtesë të nevojshme. Po ashtu përgjegjësi i dytë kryesor i programit nuk ka qenë prezent dhe vetëm personi i tretë përgjegjës ishte prezent. Po ashtu në takimin me stafin akademik, asnjëri nga stafi prezent nuk ishte i përfshirë në programin nën vlerësim.

Sipas ekspertëve ani pse ideja e përgjithshme e programit është në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe se koncepti i përgjithshëm është i krahasueshëm me disa universitete evropiane, ekzistojnë një mori të mangësive për programin e ofruar në Universitetin e Pejës. Sipas ekspertëve një program me strukturë ndër disiplinare, si për sa i përket mësimdhënies dhe hulumtimit, duhet të realizohet nga bashkëpunimi i ekspertëve të fushave të ndryshme. Por ekspertët kanë mësuar se vetëm disa mësimdhënës janë të përhirë si mësimdhënës për të ofruar këtë program të studimit shumë kompleks dhe delikat. Sipas ekspertëve disa nga ligjëruesit nuk kanë përvojë të pasur për të ofruar programin e studimit. Gjitha publikimet e stafit akademik janë të publikuara në revista të kualitetit të dobët të cilat kanë borde të dyshimta të rishikimit.

Për sa i përket hulumtimit, ekspertët kanë deklaruar se Universiteti i Pejës ka nivel shumë të ulët të hulumtimit për të ofruar këtë program të veçantë të studimit. Në anën tjetër infrastruktura e Universitetit për këtë program të studimit i përket Fakultetit të Agrobiznesit dhe se laboratorët janë të zbrastë dhe steril pasi iu mungojnë disa nga elementet infrastrukturore, kemikalet dhe materialet e tjera. Për më tepër ekspertët kanë mësuar nga studentët se puna praktike është shumë e kufizuar dhe në fakt puna praktike e studentëve është bërë duke realizuar vizita në institucioneve të ndryshme duke prezantuar disa probleme praktike të ambientit. Për ekspertët kjo është e pamjaftueshme për të zhvilluar aftësitë e studentëve në menaxhimin e ambientit.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi mund të paraqitet kërkesë për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 126, pika 2 a, të Ligjit mbi Procedurën Administrative nr. 02/L-28. Kërkesa për rishqyrtim të vendimit i dorëzohet Agjencinë e Kosovës për Akreditim në afatin prej 30 ditëve nga data e pranimit të këtij vendimi siç është përcaktuar në nenin 130, pika 1 e Ligjit mbi Procedurën Administrative.

Vendimi iu dërgohet:

- Universiteti i Pejës “Haxhi Zeka”;
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.



---

Prof. Asoc. Dr. Blerim Rexha  
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë